

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Raportimi Financiar i
Avancuar**

P9

Zgjidhjet

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Data 23.10.2021

1. Bush sh.a, një entitet biznesi ka blerë dy filiala dhe një ortakëri. Draft Pasqyrat e Pozitës Financiare të Bush sh.a-së dhe dy filialave e saj më 31 dhjetor 2020 janë si më poshtë:

	Bush sh.a €milion	Blair sh.a €milion	Cohen sh.a €milion
<i>Pasuritë jo-qarkulluese</i>			
Pas. e patun., imp. e prodh. dhe paisjet	265	230	161
Investimet në filiala:			
Blair sh.a	300		
Cohen sh.a	128		
Investimet në ortakëri – Robertson sh.a	20		
Pasuritë financiare përmes TTGJ	<u>51</u>	<u>6</u>	<u>5</u>
	764	236	166
<i>Pasuritë qarkulluese</i>			
Stoqet	135	55	73
Të arkëtueshmet tregtare	91	45	32
Paraja dhe ekuivalentët e parasë	<u>102</u>	<u>100</u>	<u>8</u>
	<u>328</u>	<u>200</u>	<u>113</u>
Total pasuritë	1,092	436	279
<i>Ekuiteti</i>			
Aksionet e zakonshme	520	220	100
Fitimet e mbajtura	240	150	80
Komponentë të tjerë të ekuitetit	<u>12</u>	<u>4</u>	<u>7</u>
Total ekuiteti	772	374	187
<i>Detyrimet afatgjata</i>			
Huatë afatgjata	<u>145</u>	<u>24</u>	<u>8</u>
	145	24	8
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>			
Llogaritë tregtare dhe të pagueshmet tjera	115	30	60
Tatimi aktual i pagueshëm	<u>60</u>	<u>8</u>	<u>24</u>
	<u>175</u>	<u>38</u>	<u>84</u>
Total detyrimet	320	62	92
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,092	436	279

Informatata në vijim janë të rëndësishme për përgatitjen e pasqyrave financiare të grupit:

- i) Më 1 janar 2020, Bush bleu 80% të aksioneve të zakonshme të Blair sh.a një kompani private. Pagesa e blerjes ishte para në vlerë prej €300 milion. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Blair sh.a-së ishte €400 milion, përfshirë çdo detyrim të tatimit të shtyrë që krijohet nga blerja. Pronarët e Blair sh.a-së duhej ta shisnin për qëllime tatimore deri në një datë të caktuar, prandaj ia shitën kompaninë kompanisë së parë që ofertoi për të, e cila ishte Bush sh.a. Një vlerësues i pavarur ka deklaruar se vlera e drejtë e interesit jokontrollues në Blair sh.a ishte €86 milionë më 1 janar 2020. Bush sh.a nuk dëshiron të matë interesin jokontrollues me pjesën e tij proporcionale të (vlerës së drejtë) të pasurive neto të identifikueshme të filialit, por shpreson të përdorë metodën e vlerës së drejtë (ose të plotë). Fitimet e pashpërndara të Blair sh.a ishin €136 milion, dhe komponentët e tjerë të kapitalit ishin €4 milion në datën e blerjes. Nuk

kishte pasur asnjë emetim të ri të aksioneve nga Blair sh.a që nga data e blerjes dhe teprica e vlerës së drejtë mbi vlerën në libra të pasurive neto të identifikueshme është për shkak të vlerës së tokës së pa-zhvlerësueshme.

- ii) Më 1 janar 2019, Bush bleu 6% të aksioneve të zakonshme të Cohen sh.a-së. Bush sh.a e kishte trajtuar këtë investim si një pasuri financiar përmes TTGJ në pasqyrat financiare deri më 31 dhjetor 2019, por kishte riparqitur investimin sipas kostos pasi që Cohen sh.a u bë filial. Më 1 janar 2020, Bush sh.a bleu 64% të aksioneve të zakonshme të Cohen sh.a-së dhe mori kontrollin e kompanisë. Konsiderata për blerjet ishin si më poshtë:

	Pronësia	Konsiderata
	%	€'milion
1 janar 2019	6	10
1 janar 2020	<u>64</u>	<u>118</u>
	70	128

Sipas marrëveshjes së blerjes, më 1 janar 2020, Bush sh.a-së i kërkohet të ju paguajë ish aksionerëve 30% të fitimeve të Cohen sh.a-së më 31 dhjetor 2021 për secilin nga vitet financiare në 31 dhjetor 2020 dhe 31 dhjetor 2021. Vlera e drejtë e kësaj marrëveshjeje u vlerësua në €12 milion më 1 janar 2020, dhe më 31 dhjetor 2020, kjo vlerë nuk kishte ndryshuar. Kjo shumë nuk është përfshirë në pasqyrat financiare.

Më 1 janar 2020, vlera e drejtë e interesit të ekuitetit në Cohen sh.a të mbajtur nga Bush sh.a para kombinimit të biznesit ishte €15 milion. Vlera e drejtë e interesit jokontrollues në Cohen sh.a ishte €53 milion.

Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme në 1 janar 2020 të Cohen sh.a ishte €170 milion, dhe fitimet e pashpërndara dhe komponentët e tjerë të ekuitetit ishin €55 milion dhe €7 milion, respektivisht. Nuk kishte pasur asnjë emetim të ri të aksioneve nga Cohen sh.a që nga data e blerjes, dhe teprica e vlerës së drejtë mbi vlerën në libra të pasurive neto të identifikueshme është për shkak të vlerës së pasurive të patundshme, impianteve të prodhimit dhe pajisjeve. Vlera e drejtë e pasurive të patundshme, impianteve të prodhimit dhe pajisjeve ishte e përkohshme dhe në pritje të marrjes së vlerësimit përfundimtar për këto pasuri. Ky vlerësim u mor më 1 korrik 2020 dhe rezultoi në një rritje të mëtejshme prej €6 milion në vlerën e drejtë të pasuriveve neto të identifikueshme në datën e blerjes. Kjo rritje nuk ndikon në vlerën e drejtë të interesit jo-kontrollues. Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet zhvlerësohen në baza lineare gjatë shtatë viteve. Injoroni çdo implikim tatimor.

- iii) Bush sh.a bleu 10% të aksioneve të zakonshme në Robertson sh.a, një entitet biznesi privat, më 1 janar 2019 për €8 milion. Investimi u kontabilizua si një pasuri financiar përmes TTGJ, dhe më 31 dhjetor 2019, vlera e tij ishte €9 milion. Më 1 janar 2020, Bush bleu edhe 15% të aksioneve të zakonshme në Robertson sh.a për €11 milion dhe arriti ndikim domëthënës. Robertson sh.a kishte fitime pas dividendëve prej €6 milion dhe €10 milion për vitet deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020.

- iv) Më 1 janar 2019, sh.a bleu një instrument të ekuitetit në valutë të huaj prej \$11 milion (dollar amerikan) me vlerën e tij të drejtë. Instrumenti u klasifikua si një pasuri financiare përmes TTGJ. Kurset përkatëse të këmbimit dhe vlerat e drejta ishin si më poshtë:

	€ për \$1	VD e instrumentit - dollarë \$ milion
1 janar 2019	4.5	11
31 dhjetor 2019	5.1	10
31 dhjetor 2020	4.8	7

Bush sh.a nuk ka regjistruar ndonjë ndryshim në vlerën e instrumentit që nga 31 dhjetor 2019. Rënia e vlerës së drejtë më 31 dhjetor 2020 konsiderohet të jetë si rezultat i dëmtimit.

v) Nuk ka dëmtim të zërit të mirë në blerje.

Kërkohet:

Përgatite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020 për grupin Bush sh.a. (25 pikë)

Zgjidhja e problemit 1

Grupi Bush sh.a Pasqyra e Konsoliduar e Pozitës Financiare me 31 dhjetor 2020

<i>Pasuritë jo-qarkulluese:</i>	€m
Pas. e patun., imp. e prodh. dhe paisjet (265+230+161+40+14-2)L17	708
Zëri i mirë L12	22
Investimi në ortakëri L13	22.5
Pasuritë financiare përmes TTGJ (51+6+5-17.4)	<u>44.6</u>
	797.1
<i>Pasuritë qarkulluese:</i>	
Stoqet (135+55+73)	263
Të arkëtueshmet tregtare (91+45+32)	168
Paraja dhe ekuivalentët e parasë (102+100+8)	<u>210</u>
	641
Total pasuritë	1,438.1
<i>Ekuiteti</i>	
Aksionet e zakonshme	520
Fitimet e mbajtura L15	273.9
Komponentë të tjerë të ekuitetit L15	<u>9.5</u>
	803.4
Interesi jo-kontrollues L17	<u>148.7</u>
	952.1
<i>Detyrimet afatgjata</i>	
Huatë afatgjata (145+24+8)	<u>177</u>
Total detyrimet afatgjata	177
<i>Detyrimet afatshkurtëra</i>	
Llogaritë tregtare dhe të pagueshmet tjera (115+30+60+12)	217
Tatimi aktual i pagueshëm (60+8+24)	<u>92</u>
Total detyrimet afatshkurtëra	<u>309</u>
Total detyrimet	486
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,438.1

Llogaritjet

1. Struktura e grupit

	Blair sh.a	Cohen sh.a	Robertson sh.a
Interesi i Bush.sh.a	80%	70%	25%
IJK/Interesi tjetër	20%	30%	75%
	100%	100%	100%
	Filial 1 vit	Filial 1 vit	Filial 1 vit
<i>Pasuritë neto: Blair sh.a</i>			
	Në datën e raportimit	Në blerje	Pas blerjes
Aksionet e zakonshme	220	220	-
Fitimet e mbajtura	150	136	14
Komponentët tjerë	4	4	-
Korigjim i VD - Toka	<u>40</u>	<u>40</u>	=
	414	400	14
<i>Pasuritë neto: Cohen sh.a</i>			
	Në datën e raportimit	Në blerje	Pas blerjes
Aksionet e zakonshme	100	100	-
Fitimet e mbajtura	80	55	25
Komponentët tjerë	7	7	-
Korigjim i VD - PP, IM dhe paisjet	<u>12</u>	<u>14 (8+6)</u>	<u>2</u>
	199	176	27

2. Zëri i mirë

	€m
Blair sh.a:	
Vlera e drejtë e konsideratës për 80% të aksioneve të zakonshme	300
Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues	<u>86</u>
	386
Shuma e pasurive ento të identifikueshme	<u>(400)</u>
Fitimi në blerjen me zbritje	(14)
Hyrjet do të jenë:	
Debi Pasuritë neto të identifikueshme	400
Kredi Paraja	300
Kredi Fitimi në blerjen me zbritje	14
Kredi Ekuitet - interesi jo-kontrollues	86
Cohen sha:	
1 janar 2020 (128 - 10)	118
Konsiderata kontigjente	<u>12</u>
Total konsiderata	130
Vlera e drejtë e interesit të ekuitetit të mbajtur para kombinimit të biznesit	<u>15</u>
Vlera e drejtë e konsideratës	145
Vlera e drejtë e interesit jo-kontrollues	<u>53</u>
	198
Pasuritë neto të identifikueshme	(170)

Rritja në vlerë	<u>(6)</u>
Zëri i mirë	22

3. Investimi në ortakëri – Robertson sh.a

Fitimi prej €1 milion i regjistruar brenda komponentë të tjerë të ekuitetit tani duhet të konsiderohet i realizuar pasi pronësia është rritur në 25%. Kërkohej një rregullim për të riklasifikuar këtë fitim.

	€m	€m
Debi Komponentë të tjerë të ekuitetit (9 – 8)	1	
Kredi Fitimi ose humbja (fitimet e mbajtura)		1

Shuma e përfshirë në pasqyrën e konsoliduar të pozitës financiare do të jetë:

	€m
Kosto (€9 milion + €11 milion)	20
Pjesa e fitimeve pas blerjes (€10 milion x 25%)	<u>2.5</u>
	22.5

4. Pasuritë financiare përmes TTGJ

Data	Kursi i këmbimit	Vlera në dollarë \$m	€m	Ndyshimi në VD
1 janar 2019	4.5	11	49.5	
31 dhjetor 2019	5.1	10	51	1.5
31 dhjetor 2020	4.8	7	33.6	(17.4)

Vlera e drejtë e pasurisë në valutë të huaj ka rënë për periudha të njëpasnjëshme. Megjithatë, asnjë humbje nga dëmtimi nuk njihet në vitin që përfundon më 31 dhjetor 2019 pasi nuk ka humbje në valutën raportuese (€). Fitimi prej €1.5 milion do të regjistrohej në ekuitet. Sidoqoftë, në vitin deri më 31 dhjetor 2020 një humbje nga dëmtimi prej €17.4 milionë do të regjistrohet si në vijim:

	€m	€m
Debi Komponentë të tjerë të ekuitetit	1.5	
Debi Fitimi ose humbja	15.9	
Kredi Pasuritë financiare përmes TTGJ		17.4

5. Fitimet e mbajtura €m

Bush sh.a:	
Saldo me 31 dhjetor 2020	240
Fitimet e ortakërisë (25% x 10)	2.5
Dëmtimi i pasurive financiare L14	(15.9)
Rritja në vlerën e drejtë të Robertson sh.a tani e realizuar	1
Rritja në vlerën e drejtë të interesit të ekuitetit – Cohen sh.a (15 – 10)	5
Fitimi në blerjen me zbritje	14
Rezervat pas blerjes:	
Blair sh.a: (150 -136) x 80%	11.2
Cohen sh.a: [(80-55) - 2] x 70%	<u>16.1</u>
	273.9

Bush sh.a: Komponentë të tjerë të ekuitetit	
Saldo me 31 dhjetor 2020	12
Investimi në ortakëri L13	(1)

Dëmtimi i pasurive financiare L14 (1.5)
9.5

6. Interesi jo-kontrollues €m
Blair sh.a 86
Rezervat pas blerjes (20% x 14) 2.8
88.8

Cohen sh.a 53
Rezervat pas blerjes [(80-55)-2] x 30% 6.9 59.9
Total **148.7**

7. Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet

€m
Bush sh.a 265
Blair sh.a 230
Cohen sh.a 161
656

Rritja në vlerën e tokës- Blair sh.a (400 - 220 - 136 - 4) 40
Rritja në vlerën e PP, IP dhe P- Cohen sh.a (176 - 100 - 55 - 7) 14
Minus: zhvlerësimi shtesë (14 / 7) (2)
708

2.

Të dhënat në vijim kanë të bëjnë me skemen e kompensimit të përfitimeve të paracaktuara pas ndërprerjes së marrëdhënies së punës të punonjësve të Holbrooke sh.a:

Norma e skontimit (çdo vit)	12.50%
Vlera e tanishme e obligimeve me 1 janar 2019	€1,200,000
Vlera e drejtë e pasurive të planit me 1 janar 2019	€1,075,000

Informata tjera të rëndësishme:

	2019	2020
	€	€
Kostot aktuale të shërbimit	150,000	225,000
Përfitime të paguara jashtë	160,000	240,000
Kontributet e paguara prej entitetit	110,000	120,000
Vlera e tanishme e obligimeve në fund të vitit	1,350,000	1,600,000
Vlera e drejtë e pasurive të planit në fund të vitit	1,164,000	1,250,000

Kërkohet:

Llogariti shumat që duhet të prezantohen në Pasqyrën e Pozitës Financiare, Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes dhe Pasqyrën e të Ardhurave Tjera Gjithëpërfshirëse për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2020. (15 pikë)

Zgjidhja e problemit 2

	€	€
	2019	2020
VT e obligimeve në fillim të vitit	1,200,000	1,350,000
Kostoja e interesit (12.5%)	150,000	168,750
Kostot aktuale të shërbimit	150,000	225,000
Përfitime të paguara jashtë	<u>(160,000)</u>	<u>(240,000)</u>
	1,340,000	1,503,750
Humbja në rimatje (shif./bal.) TTGJ	10,000	96,250
VT e obligimeve në fund të vitit	1,350,000	1,600,000
Vlera e tregut të pasurive të planit në fillim të vitit	1,075,000	1,164,000
Interesi në pasuritë e planit (12.5%)	134,375	145,500
Përfitime të paguara jashtë	<u>(160,000)</u>	<u>(240,000)</u>
Kontributet	<u>110,000</u>	<u>120,000</u>
	1,159,375	1,189,500
Kthimi në pasuritë e planit duke përjashtuar - - shumat në interesin neto (shif./bal.) TTGJ	<u>4,625</u>	<u>60,500</u>
Vlera e tregut të pasurive të planit në fund të vitit	1,164,000	1,250,000
Pasqyra e Pozitës Financiare		
VT e obligimeve të planit	1,350,000	1,600,000
Vlera e drejtë e pasurive të planit	<u>(1,164,000)</u>	<u>(1,250,000)</u>
Neto detyrimi i përfitimeve të paracaktuara	186,000	350,000
Shumat që duhet të tregohen në Pasqyrën e Fitimit ose Humbjes:		
Kostot aktuale të shërbimit	150,000	225,000
Interesi në obligimet	150,000	168,750
Interesi në pasuritë e planit	<u>(134,375)</u>	<u>(145,500)</u>
	165,625	248,250
Shumat tjera që duhet të njihen në të Ardhurat Tjera Gjithëpërfshirëse		
Komponenta neto e rimatjes (10,000-4,625) / (96,250-60,500)	<u>5,375</u>	<u>35,750</u>
Total të Ardhurat Gjithëpërfshirëse për vitin	171,000	284,000

3.

a) Në përputhje me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*, një entitet do të klasifikojë një pasuri jo-qarkulluese (ose grup t'u larguar [shitur]) si të mbajtur për shitje nëse vlera kontabël neto e tij do të mbulohet kryesisht nëpërmjet një transaksioni shitjeje sesa përmes përdorimit të vazhdueshëm.

Më 1 janar 2016, DioGuardi sh.a bleu një pajisje me një kosto prej €450,000 dhe zhvlerësohet në bazë lineare gjatë jetës së tij të dobishme ekonomike prej 15 vjetësh. Data e raportimit të DioGuardi sh.a-së është 31 dhjetor. Më 30 shtator 2020, pajisjet nuk ishin më të nevojshme nga DioGuardi sh.a. U vendos që paisja të shitej dhe po kërkohet një blerës. Paisja reklamohet për shitje me një çmim prej €275,000, që ishte një pasqyrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë. Pritet që një kosto transporti prej €30,000 do të ndodhë për të dërguar paisjen tek blerësi. Shitja pritet të ndodhë brenda një viti.

Kërkohet:

i) Shpjegoni 'konceptin e grupit të pasurive të lëna për t'u larguar [shitur]' sipas SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. (2 pikë)

ii) Demonstroni se si të llogarisni për transaksionin e mësipërm më 31 dhjetor 2020 në përputhje me SNRF 5 *Pasuritë jo-qarkulluese të mbajtura për shitje dhe operacionet e ndërprera*. (3 pikë)

b) Rubin sh.a është një bankë e kontrolluar nga qeveria. Rubin sh.a u vendos në pronësi të Qeverisë gjatë shpëtimit (ndihmës) së fundit financiare të siguruar nga Qeveria. Rubin sh.a nuk bën tregti drejtpërdrejt me bankat e tjera të kontrolluara nga qeveria, por ka nënshkruar zhvillimin e shërbimit postar në pronësi kombëtare dhe ministrisë së sapo krijuar të hekurudhave. Drejtorët e Rubin sh.a janë të shqetësuar për vëllimin dhe koston e shpalosjeve të interesave të palëve të ndërlidhura me të, sepse ato shtrihen teorikisht me të gjitha ndërmarrjet dhe bankat e tjera të kontrolluara nga qeveria. Drejtorët kërkojnë këshilla të përgjithshme mbi natyrën dhe rëndësinë e shpalosjes së marrëdhënieve me palët e ndërlidhura dhe këshilla specifike për shpalosjen e marrëdhënieve të mësipërme në pasqyrat financiare.

Kërkohet: Këshilloni drejtorët e Rubin sh-së se si të trajtojnë transaksionin e mësipërm në pasqyrat financiare në përputhje me SNK 24 *Shpalosjet e palëve të ndërlidhuara*. (5 pikë)

c) Ju jeni Drejtori i Financave i një kompanie me përgjegjësi të kufizuar. Kompania filloi aktivitetin me një numër të vogël punonjësish, por tani ka një fuqi punëtore prej 200. Ju jeni të vetëdijshëm se blerjet mallrave të prodhuara nga kompania prej stafit të janë të autorizuara nga menaxherët e prodhimit, dhe më pas procesohen jashtë sistemit të kontabilitetit, pra nuk regjistrohen në sistemin e kontabilitetit. Të ardhurat nga këto shitje përdoren për të financuar festën vjetore të Vitit të Ri, të organizuar vetëm për drejtorët e kompanisë.

Kërkohet:

Diskutoni veprimet e mundshme që do të ndërmerrni për të mos shkelur parimet themelore të Kodit të Etikës të IFAC. (10 pikë)

(total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 3

3.

a)

i)

Grupi i pasurive të lëna për t'u larguar [shitur]: një grup i pasurive që do të largohen, duke u shitur ose me mënyra të tjera, bashkë si një grup në një transaksion të vetëm, dhe detyrimet që kanë të bëjnë drejt për së drejti me këto pasuri të cilat do të transferohen në transaksionin në fjalë. (Në praktikë një grup i pasurive të lëna për t'u larguar [shitur] mund të jetë një filial, një njësi që gjeneron para të gatshme ose një veprimtari e vetme brenda për brenda një entiteti.

Grupi përfshin emtin e mirë të blerë në një kombinim biznesi nëse grupi është një njësi gjeneruese e mjeteve monetare, së cilës emri i mirë i është alokuar në përputhje me SNK 36 *Dëmtimi i pasurive* ose nëse është një operacion brenda një njësie të tillë gjeneruese të mjeteve monetare.

ii) Meqenëse vlera e drejtë është më e ulët, pasuria duhet të matet në €245,000 (L13) në Pasqyrën e Pozitës Financiare.

LL1	€
Kostoja 1 janar 2016	450,000
Zhvlerësimi deri më 31 dhjetor 2019 (450,000 x 1/15 x 4 vjet)	<u>(120,000)</u>
Vlera bartëse 31 dhjetor 2019	330,000
Zhvlerësimi 1 janar 2020 deri më 30 shtator 2020 (450,000 x 1/15 x 9/12)	<u>(22,500)</u>
Vlera bartëse më 31 shtator 2020	307,500

L12	€
Vlera e drejtë minus koston për të shitur	€
Vlera e drejtë	275,000
Shpenzimet e shitjes	<u>(30,000)</u>
	245,000

L13
Krahasoni vlerën bartëse me një vlerë të drejtë minus koston për të shitur dhe zgjidhni më të ulët

	€
Vlera bartëse	307,500
Vlera e drejtë minus kosto për të shitur	245,000

Meqenëse vlera e drejtë është më e ulët, paisja duhet të matet në €245,000.

Humbje nga dëmtimi (€307,500-245,000) = €62,500

Debi	Kostoja e shitjeve	62,500	
Kredi	PJQ mbajtur për shitje		62,500

b) Sipas SNK 24 *Shpalosjet e Palëve të ndërlidhura*, dhënia e informacioneve shpjeguese kërkohet në lidhje me transaksionet e një entiteti me palët e ndërlidhura. Palët e ndërlidhura përfshijnë kompanitë prind, filialet, anëtarët e personelit kryesor menaxhues të entitetit ose të një kompanie prindi të entitetit dhe planet e përfitimeve të punonjësve. Aty ku ka pasur transaksione të palëve të ndërlidhura gjatë periudhës, menaxhmenti shpalos natyrën e marrëdhënies, si dhe informacion në lidhje me transaksionet dhe saldot e papaguara, përfshirë angazhimet, të nevojshme për përdoruesit për të kuptuar ndikimin e mundshëm të marrëdhënies në pasqyrat financiare. Shpalosja bëhet sipas kategorisë së palëve të ndërlidhura dhe sipas llojit kryesor të transaksionit. Menaxhmenti shpalos vetëm se transaksionet e palëve të lidhura janë bërë me kushte ekuivalente me ato që mbizotërojnë në transaksionet duarlibër, nëse këto kushte mund të vërtetohen.

Subjektet e ndërlidhura me Qeverinë përcaktohen si njësi që kontrollohen, kontrollohen së bashku ose ndikohen ndjeshëm nga qeveria. Mbështetja financiare e ofruar nga qeveria për institucionet financiare në shumë vende nënkuptoi që kontrollet e qeverisë ndikuan ndjeshëm në disa prej këtyre entiteteve.

Një bankë e kontrolluar nga Qeveria, në parim, do të kërkohej të shpaloste detajet e transaksioneve, depozitave dhe angazhimeve të saj me të gjitha bankat e tjera të kontrolluara nga Qeveria. Megjithatë, SNK 24 ka një përjashtim nga të gjitha kërkesat për dhënie e informacioneve shpjeguese të SNK 24 për transaksionet midis entiteteve të ndërlidhura me Qeverinë dhe Qeverisë, dhe të gjitha entiteteve të tjera të lidhura me Qeverinë.

Rubin sh.a përjashtohet nga kërkesat për dhënie informacionesh shpjeguese në lidhje me transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe saldot e papaguara, përfshirë angazhimet, në lidhje me sa vijon:

- (a) një qeveri e cila ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm mbi njësinë raportuese; dhe
- (b) një entitet tjetër e cila është palë e ndërlidhur sepse e njëjta qeveri ka kontroll, kontroll të përbashkët ose ndikim të rëndësishëm si mbi njësinë raportuese ashtu edhe për entitetin tjetër.

Ato shpalosje zëvendësohen me një kërkesë për të shpalosur:

- Emrin e Qeverisë dhe natyra e marrëdhënies së tyre; dhe
- Natyra dhe shuma e çdo transaksioni të rëndësishëm individualisht; dhe
- Shtrirja e çdo transaksioni të rëndësishëm kolektivisht cilësor ose sasior

c)

Integriteti

Duhet të jeni të sinqertë dhe të drejtpërdrejtë në ushtrimin e integritetit tuaj. Mos paraqitja e të ardhurave nga shitjet e stafit do të rezultojë që pasqyrat financiare të jenë mashtruese. Përsëri, kjo praktikë është e pandershme, dhe ajo që duhet bërë është të formalizohet sistemi aktual i përdorur për shitjet e stafit dhe financimin e festës së Vitit të Ri.

Objektiviteti

Reputacioni i kompanisë tuaj mund të dëmtohet dhe ju duhet ta diskutoni këtë dilemë etike me menaxherët tuaj të prodhimit dhe më pas drejtorët.

Kompetenca profesionale dhe kujdesi i duhur

Ju duhet të siguroheni që informacioni financiar që nxjerrni për kompaninë të jetë në përputhje me standardet teknike dhe profesionale.

Sjellja profesionale

Ju duhet të veproni profesionalisht në një mënyrë të tillë për të mbrojtur reputacionin tuaj si Drejtor i Financave, dhe profesionit të kontabilitetit në përgjithësi. Duke vepruar kështu, ju duhet të merrni parasysh standardet përkatëse të kontabilitetit dhe çdo ligj dhe rregullore të zbatueshme. Ju gjithashtu duhet të përcaktoni sistemin e përdorur aktualisht për kontrollin dhe kontrollin e shitjeve të stafit dhe financimin e festës së Vitit të Ri të drejtorëve.

Konflikti i interesit

Duket se ka konflikt interesi. Duhet të jeni objektiv në raportimin e plotë të blerjeve të stafit të mallrave të kompanisë.

Veprimet e mundshme

- Pasi ta keni vënë çështjen në vëmendjen e menaxherëve tuaj dhe të keni marrë detajet përkatëse të sistemit të klientit për llogaritjen e shitjeve të stafit, ju duhet të ngrini shqetësimet tuaja me drejtorët e Kompanisë.
- Ju gjithashtu do të duhet të përcaktoni nëse pasqyrat financiare të viteve të kaluara ka të ngjarë të jenë mashtruese dhe, nëse po, merrni parasysh përgjegjësinë tuaj për të informuar autoritetet përkatëse (përfshirë autoritetet tatimore).
- Ju duhet t'i këshilloni fuqishëm drejtorët që duhet të prezantohet një politikë e shitjeve të stafit për të siguruar që këto shitje të regjistrohen plotësisht në sistemin e kontabilitetit të kompanisë në të ardhmen.
- Ju duhet t'u shpjegoni drejtorëve implikimet e veprimeve të tyre dhe se po mbron interesat e kompanisë dhe stafit të saj në këshillimin se si mund të korrigjohet situata.
- Nëse drejtorët janë bashkëpunues, ju duhet t'i këshilloni ata për ndryshimet e rekomanduara në sistemin e kontabilitetit dhe se si ata mund t'i shpalosin të ardhurat e panjohura të kaluara autoritetit tatimor.
- Nëse drejtorët duken të gatshëm të ndryshojnë sistemin në lidhje me shitjet e stafit, ju jeni të detyruar të shkëputeni nga çdo përfshirje në pasqyrat financiare të kompanisë, dhe kjo do t'ju kërkojë të jepni dorëheqjen si drejtor financiar i kompanisë.
- Në çdo kohë, ju mund të kërkonit këshilla nga ShKÇAK.
- Duke pasur parasysh këtë, ju jeni të detyruar të merrni parasysh detyrimet tuaja të sinjalizimit dhe mund t'ju duhet të raportoni çështjen tek një ose më shumë autoritete. Kjo do të jetë në interesin publik dhe nuk përbën shkelje të konfidencialitetit.
- Si mjet i fundit, duhet të dokumentoni, në detaje, hapat që ndërmerrni për të zgjidhur dilemën tuaj, në rast se gjykimi juaj etik sfidohet në të ardhmen.

4.

a) Cook sh.a, viti financiar i së cilës përfundon me 31 dhjetor, ka fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm prej €4 milion në vitin 2020. Numri i aksioneve të zakonshme me 1 janar 2020 ishte 30 milion. Me 1 maj 2020 Cook sh.a emetoi edhe 15 milion aksione të zakonshme me vletë të drejtë të tregut. Me 1 nëntor 2020 ribléu 3 milion aksione të zakonshme.

Kërkohet:

Llogarite fitimin e thjeshtë për aksion (FPA) në pajtim me SNK 33 *Fitimet për aksion të Cook sh.a-së për vitin 2020 duke u bazuar në informatat mësipër.* (2 pikë)

b) Goldfein sh.a, viti financiar i së cilës përfundon me 31 dhjetor, ka fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm prej €100,000 për vitin 2020. Numri i aksioneve të zakonshme me 1 janar 2020 ishte 500,000. Me 31 maj 2020 u bë një emetim bonus, kushtet e të cilit ishin 3 aksione të reja për çdo 5 aksione ekzistuese.

FPA e raportuar për vitin 2019 ishte 15 cent.

Kërkohet:

Llogarite fitimin e thjeshtë për aksion në pajtim me SNK 33 *Fitimet për aksion të Goldfein sh.a-së për vitin 2020 duke u bazuar në informatat mësipër. Llogarite gjithashtu informatën krahasuese për vitin 2019 që do të shpaloset në pasqyrat financiare të vitit 2020.* (3 pikë)

c) Gelbard sh.a viti financiar i së cilës përfundon me 31 dhjetor, kishte 750,000 aksione të zakonshme me 1 janar 2020. Fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm për vitin 2020 ishte €50,000.

Gelbard sh.a bëri një emetim për të drejtat 1 për 4 me 30 prill 2020 me një çmim prej €1.00. Çmimi i tregut i një aksioni me 31 mars 2020 ishte €1.25

FPA për vitin 2019 ishte 9 cent

Kërkohet:

Llogarite fitimin e thjeshtë për aksion në pajtim me SNK 33 *Fitimet për aksion të Goldfein sh.a-së për vitin 2020 duke u bazuar në informatat mësipër. Llogarite gjithashtu informatën krahasuese për vitin 2019 që do të shpaloset në pasqyrat financiare të vitit 2020.* (5 pikë)

d) Vlera e drejtë është matje e bazuar në treg, jo matje specifike e entitetit. Për shkak se është një matje e bazuar në treg, vlera e drejtë matet duke përdorur supozimet që pjesëmarrësit në treg do të përdornin kur të vendosnin çmimin e pasurisë, duke marrë parasysh ndonjë karakteristikë relevante të pasurisë.

Kërkohet:

i) Shpjegoni qasjet në vlerësim të lejuara me SNRF 13 *Matjet e vlerës së drejtë.* (5 pikë)

ii) Tregoni disa shembuj të inputeve të përdorura për të matur vlerën e drejtë. (5 pikë)

(total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 4

a)

Fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm €4 milion

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme për vitin 2020:

Datat	Numri i aksioneve	Pesha kohore	Numri mesatar
1 jan. - 1 maj	30 milion	4/12	10.0 milion
1 maj - 31 tet.	(30 + 15) 45 milion	6/12	22.5 milion
1 nën. - 31 dhje.	(45 - 3) 42 milion	2/12	<u>7.0 milion</u>
Total			39.5 milion

FPA e thjeshtë = €4 milion / 39.5 milion = €0.101 (ose 10.1 cent) për aksion.

b)

Fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm €100,000

Fraksioni bonus = $(5+3) / 5 = 8/5$

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme për vitin 2020:

Datat	Nr. i aksioneve	Pesha kohore	Fraksioni	Nr. i peshuar
1 jan. - 31 maj	500,000	5/12	8/5	333,333
1 qer. - 31 dhje.	800,000	7/12		<u>466,667</u>
Total				800,000

FPA e thjeshtë = €100,000 / 800,000 = €0.125 (ose 12.5 cent) për aksion.

FPA e vitit 2019 korigjohet për vlerën reciproke të fraksionit bonus:

FPA e 2019 e riparaqitur: $15c \times 5/8 = 9.375$ cent

c)

Fitim neto që i atribuohet aksionarëve të zakonshëm €50,000

Çmimi teorik pa të drejta:

Për çdo 4 aksione që kanë qenë të emetuara, me çmim €1.25 secila, vlera totale është €5.00

Ka pasur 1 aksion shtesë, me një çmim prej €1.00, duke shtuar vlerë prej €1.00

Tani ka një total prej 5 aksioneve, me vlerë totale prej €6.00

Andaj, vlera mesatare për aksion duhet të jetë (€6.00 / 5 aksione) = €1.20

Fraksioni bonus = $1.25 / 1.20$

Ky është faktor korigjues që aplikohet për të gjitha periudhat paraprake deri me datën e emetimit të të drejtave.

Numri i aksioneve korigjohet për emetimin e të drejtave sa i përket të gjitha periudhave të ardhshme.

Numri mesatar i ponderuar i aksioneve të zakonshme për vitin 2020:

Datat	Nr i aksioneve	Koha	Fraksioni	Nr. i peshuar
1 jan - 30 prill	750,000	4/12	1.25/1.20	260,417
1 maj - 31 dhje.	937,500*	8/12		<u>625,000</u>
Total				885,417

*750,000 + 187,500

FPA e thjeshtë = €50,000 / 885,417 = €0.05647 (ose 5.65 cent) për aksion.

FPA e vitit 2019 korigjohet për vlerën reciproke të fraksionit bonus:

FPA e 2019 e riparaqitur: $9 \text{ cent} \times 1.20/1.25 = 8.64$ cent

d)

i) SNRF 13 *Matjet e vlerës së drejtë* identifikon tri qasje në vlerësimin.

- (a) *Qasja e të hyrave*. Teknikat e vlerësimit të cilat konvertojnë shumat e ardhshme (psh rrjedhat e parasë apo shpenzimet) në një shumë aktuale (p.sh të skontuar). Matja e vlerës së drejtë përcaktohet në bazë të vlerës së sugjeruar nga pritjet aktuale të tregut për shumat në të ardhmen.
- (b) *Qasja e tregut*. Një teknikë e vlerësimit që përdor çmimet dhe informatat tjera relevante të gjeneruara nga transaksionet e tregut të cilat përfshijnë pasuri identike apo të krahasueshme (p.sh të ngjajshme), detyrime apo grup të pasurive dhe detyrimeve, siç është një biznes.
- (c) *Qasja e kostove*. Një teknikë që reflekton shumat që mund të kërkohen aktualisht për të zëvendësuar kapacitetin e një pasurie (shpesh të referuar si një kosto aktuale e zëvendësimit).

Entitete mund të përdorin më shumë se një teknikë të vlerësimit për të matur vlerën e drejtë në një situatë të caktuar. Një ndryshim i teknikave të vlerësimit konsiderohet të jetë ndryshim në vlerësimet kontabël në pajtim me SNK, dhe duhet të shpaloset në pasqyrat financiare.

ii)

	Pasuri ose detyrim	Inputi
Niveli 1	Aksionet e ekuitetit të një kompanie të listuar	Çmimet e kuotuar të pakorrigjuara në një treg aktiv
Niveli 2	Aranzhimet e licensimit që vijnë nga kombinimet në biznes	Tarifat e të drejtave sipas kontratës me një palë jot ë ndërlidhur në fillim të aranzhimit
	Njesia gjeneruese e parasë	Shumëfishët e vlerësimit (p.sh një shumëfish i fitimeve apo të hyrave apo një matje e ngjajshme e performancës) e nxjerrë nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut, p.sh nga çmimet në transaksione të vëzhgueshme të cilat përfshijnë biznese të krahasueshme
	Mallrat e përfunduara në stoke të një dyqani të shitjes me pakicë	Çmimet ndaj klientëve të korrigjuara për ndryshimet në kushtet dhe lokacionin e njësisë së mallit në stok dhe artikuj të tjetër të stokeve të krahasueshme (ngjajshëm)
	Ndertesat e mbajtur dhe përdorur	Çmimi për metër katror i nxjerrur nga të dhëna të vëzhgueshme të tregut, psh çmimet në transaksionet e vëzhguara të ndërtesave të krahasueshme në lokacione të ngjajshme
Niveli 3	Njesia gjenreuese e parasë	Parashikimi financiar (p.sh i rrjedhave të parasë apo fitimit ose humbjes) të krijuara duke përdorur të dhënat e vet entitetit
	Opcioni tre-vjeçar për aksione të tregtuara në burse	Volatiliteti historik, p.sh volatiliteti për aksionet e nxjerra nga çmimet historike të aksioneve
		Korrigjimet e konsensusit të çmimit të mesëm të tregut (pa ofertë) për trambën e zhvilluar duke përdorur të dhëna jo të vëzhgueshme në mënyrë direkte apo të vërtetuara nga të dhënat e vëzhgueshme të tregut.

5.

a) Me 1 janar 2020 Hill sh.a emetoi 2,000 obligacione me vlerë nominale prej €1,000 secila me kupon prej issue 5%. Këto janë obligacione të konvertueshme që i japin të drejtë mbajtësit të konvertojnë secilin obligacion në 20 aksione të zakonshme në datën e maturimit. Obligacionet kanë maturitet prej 3 viteve, the interesi paguhet në fund të çdo viti. Norma e interesit në treg për obligacione të ngjajshme pa të drejtë konvertimi është 8%.

Faktori i skontimi	5%	8%
Viti 1	0.9524	0.9525
Viti 2	0.9070	0.8573
Viti 3	0.8638	0.7938

Kërkohet:

Tregoni hyrjet në kontabilitet të këtij obligacioni në njohjen fillestare dhe për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020. (10 pikë)

b) Shea sh.a e aplikon modelin e kostos për kontabilizimin pas matjes fillesatë të pasurive të patundshme, impianteve të prodhimit dhe paisjeve në pajtim me SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet*.

Një ndërtesë ishte blerë për €500,000 me 1 janar 2016 dhe është zhvlerësuar me 10% në vit sipas metodës drejtvizore. Në fund të vitit 2020 është rivlerësuar në €800,000. Nuk ka ndryshim në jetën e përdorimit. Një tokë (pronë tjetër) e cila kishte kushtuar kur është blerë shumë vite më parë €30,000. Në vitin 2018 ishte rivlerësuar në €35,000. Vlera e tokës në fund të vitit 2020 ka rënë në €29,000.

Fitimi i vitit 2020 para korigjimit të rënies në vlerë të tokës ishte €60,000

Kërkohet:

i) Trego se di duhet të trajtohen zërat e mësipërm në pasqyrat financiare për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2020 dhe pergagtiti ekstraktet e Pasqyrës së Pozitës Financiare dhe Pasqyrës së të Ardhurave Gjithëpërfshirëse. (10 pikë)

(total 20 pikë)

Zgjidhja e problemit 5

5.

a)

Obligacionet e konvertueshme krijojnë instrumente borxhi dhe ekuiteti. Borxhi do të matet duke përdorur rrjedhën e skontuar të parasë dhe pjesa e mbetur regjistrohet si ekuitet

Vlera e drejtë e obligacionit = € 1,845,300 (shih tabelen mëposhtë)

Ekuitet = € 2,000,000 - \$ 1,845,300 = € 154,700

Viti	Rrjedha e parasë	FS me 8%	Vlera e tanishme
1	100,000	0.9259	92,590
2	100,000	0.8573	85,730
3	<u>2,100,000</u>	0.7938	<u>1,666,980</u>
Total	2,300,000		1,845,300

Detyrimi Financiar

Çdo vit, Hill sh.a duhet t'i paguajë interes fiks mbajtësit €100,000 (€2,000,000 x 5%) i cili bazohet në normën e interesit të obligacioneve. Sidoqoftë, shpenzimet e interesit llogariten nga saldo e detyrimit financiar dhe një norme interesi efektive. Diferenca midis shpenzimeve të interesit dhe interesit të paguar do të rrisë saldon e detyrimeve financiare. Në fund të maturimit të obligacioneve, gjendja e detyrimit financiar do të arrijë vlerën nominale (€2,000,000).

Viti	VT e RR.P	Shpenz. interesi	Interesi i paguar	Detyrimi financiar
0				
1	1,845,300	147,624	100,000	1,892,924
2	1,892,924	151,434	100,000	1,944,358
3	1,944,358	155,549	100,000	2,000,000*

* Rrumbullakësim

Hyrjet në njohjen fillestare:

LLogaria	Debi	Kredi
Paraja	2,000,000	
Detyrimi financiar		1,845,300
Ekuiteti		154,700

Në fund të vitit 1 (31 dhjetor 2020).

Shpenzimet e intereit = € 147,624 (€1,845,300 x 8%)

Diferenca = € 147,624 - € 100,000 = € 47,624 (detyrim financiar)

LLogaria	Debi	Kredi
Shpenzim i interesit	147,624	
Detyrimi financiar		47,624
Paraja		100,000

b)

		€	€
Debi	Ndërtesa - Rivlerësim (€800,000 - €500,000)	300,000	
Debi	Ndërtesa - zhvlersimi i akumuluar (€500,000 x 5 x10%)	250,000	
Kredi	Rezerva e rivlerësimit		550,000

Pasqyra e Pozitës Financiare (ekstrakt)

	€
Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet	800,000
Rezerva e rivlerësimit	550,000

Rritja e rivlerësimit duhet të tregohet si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse në Shea sh.a. Vlera kontabël duhet të rritet në €800,000 duke debituar €550,000 dhe e njehta shumë të kreditohet tek rezerva e rivlerësimit.

Kur toka u rivlerësua dy vjet më parë, teprica e rivlerësimit prej €5,000 do të kishte janë njohur si të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse dhe i janë kredituar tepricës së rivlerësimit si pjesë e ekuitetit. Toka ka rënë për €6,000, nga të cilat €5,000 duhet të ngarkojnë tepricën e rivlerësimit nëpërmjet të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse dhe pjesa e mbetur prej €1,000 duhet të jetë njihet në fitim ose humbje.

		€	€
Debi	Rezerva e rivlerësimit	5,000	
Debi	TGJ	1,000	
Kredi	Toka		6,000

Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse (ekstrakt)

Fitimi për vitin (€60,000 - €1,000)	59,000
-------------------------------------	--------

Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:

Përfitimi nga rivlerësimi i ndërtesës	550,000
Humbja nga rivlerësimi i tokës	<u>(5,000)</u>
Total të ardhurat gjithëpërfshirëse për vitin	604,000